

BIBLIOTEKA

E

8JH-1

N41

SHTETIT

GJIROKASTER

Tsuf  
Nelaj



Tufa,  
gezimi

POEZI

888-1  
N41

# ISUF NELAJ

*Tufa gëzimi*

poezi



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## **NGA FIERZA NË KUKËSIN E RI**

Mbi valët e Drinit,  
mbi një liqen drite  
me lundrën e gëzimit të jetës së re,  
nga Fierza në Kukës, sa bukur!  
Valët e Drinit Bardhë e Zi, vuajtje, varfëri,  
sot dritë e energji.

Drini i Bardhë, Drini i Zi  
bashkoheshin poshtë Kukësit,  
si një nyjë e kaltër në fyt të qytetit të vjetër,  
valët e tij herë të bardha pér arat e mbjella,  
valët e tij herë — përmbytje të tokave  
                            ndarje e dy brigjeve,  
                            ndarje e dy fshatrave,  
                            ndarje e vëllezërve.

Emri Drin ishte dhe jetë dhe vdekje,  
një antitezë në vargjet e poetëve.  
Drini i Bardhë, Drini i Zi  
në një liqen të bashkuar sot, sa mirë.  
Antiteza u përmbyt,  
epitetet më të bukura ndrisin për ty.  
Ti sot një lumë i madh i dëgjuar kudo,  
një lumë i lidhur me emrin dritë.  
Në brigjet e tua shkrepëtë përbysura,  
legjenda, tragjedi të përbysura,  
në valët e tua si në pasqyrë-brigjet e ndritura.

Drin i Bardhë, Drin i Zi  
bashkimi juaj si i dy vëllezërve në një shtëpi,  
si i dy shokëve në një llogore,  
si i dy punëtorëve në galeri,  
si i dy telave në një linjë drite,  
si i dy telave në një çifteli,  
mbi valët tua një liqen drite.

Nga Fierza në qytetin e ri  
udhëtoj me lundrën e gëzimit të jetës së re,  
sodis brigjet e dyfishuar në pasqyrën e valëve,  
brigjet e ndritura.

1982

## **BJESHKË, O BJESHKË**

Ja kosëtarët, vringëllimë e kosave,  
tingujt e fyejve të fëmijërisë.

Bjeshkë e fshatit tim!  
Kupë gjigante e blertë  
me kapakun e kaltër të qiellit sipër.

Bjeshkë —  
hapësirë pa fund blerimi...

## MALLI NUK PYET

Rruja që zbriste nga fshati në qytet,  
rruga që më lidhte me shkollën në mes  
humbet tani në liqen,  
humbasin rrugicat, shkolla, kinemaja,  
humbasin lulishtet, dyqanet e sheqerkave.  
Po malli nuk pyet  
nga fundi i liqenit i ngre.  
Imazh i tyre sa i gjallë,  
sa i plotë del.  
Del fëmijëria ime q'andej e gjallë,  
fëmijëria me sytë e lara në liqen.  
Malli nuk pyet...

## **RRJEDHA E GRURIT**

Në arat e kooperativës malore  
deri vonë natën korrëm grurin,  
drapri në duart tonë vringëllinte  
ndërsa drapri i hënës në qiel ngriu.

Në lëmi nga makina shirëse  
rrjedha e grurit binte pa ndarë,  
rrjedha e përroit atje sipër  
kish ndalur prej kohësh në sytë tanë.

Mulliri bluante kaq shumë grurë  
(sivjet si askurrë prodhime morëm);  
o shokë letrarë, shihni sa bukur  
legjendën e misrit koha po e bluan.

## NGA BISEDA ME NJË PENSIONIST

I zi ishte ai autobot i vogël  
që sillte dy herë në ditë ujë në pazar,  
rreth tij mizëri njerëzish mblidheshin,  
ujin aq të shtrenjtë e blinin me para.

Verës qytetit i thahej gryka,  
puset nëpër oborre thelloheshin shumë,  
iji në fund si një sy i përlotur,  
buza e fëmijëve — shkrumb.

Por ja, buzëqeshi dhe për nejeta.  
Partia ujin e bjeshkës solli në qytet,  
freskinë e bjeshkës e ndiejmë mes vapës,  
fëmijëve u ndrijnë faqet plot shëndet.

Dhe ja sot nga NB-ja autobotë të bardhë  
tri herë në ditë drejt qytetit marrin udhën,  
nuk sjellin më ujin e shumëpritur,  
në vend të ujit qumësht...

Kështu gjallëron jeta kudo te ne,  
çel dhe rrit lastarë të shëndetshëm,  
e si të mos gëzohet e të përtrihet  
dhe jeta e neve pleqve?...

**1980**

## UJËMBAJTËSI

Ai-liqen i bukur mes dy kodrave  
ku pijnë ujë arat fushave e kodrinave,  
ai-syri i hapur i blerimit në verë,  
ai-përmbytës i madh i thatësirave.

Bimët i përkulen rrjedhës së tij,  
llampat- turbinës së fuqishme.  
Ai — shpërthim i bimëve në kallinj,  
ai — shpërthim në trëndafila drite.

## FSHATI IM

Nga kodra përballë vështroj fshatin tim  
në gjoksin e malit të lartë,  
këmbët prej shkëmbi zgjatur deri në lumë,  
pylli sipër si vetull e gjatë.

Nga kodra përballë vështroj fshatin tim,  
shtëpitë e reja buzë shkallëve të blerta,  
parcelat si fustan i bukur fëmije  
me ngjyrat e bukura që end pranvera.

Nga kodra përballë vështroj fshatin tim,  
në pjerrësi e bucura ndritka më shumë.  
Fshati im me gjoksin mbushur me blerim,  
me këmbët prej shkëmbi zgjatur deri në lumë.

## TUFËZIMI

— *Nga biseda me një kooperativist  
pas tufëzimit të bagëtive —*

Qumështin me bidon solla në mëngjes,  
e mora në dyqanin e kooperativës,  
nuk pata asnje grindje me rojën,  
brigadierin,  
asnje fletë s'mungon në detyrat e fëmijës.

E si nuk kishim parë më larg  
se ai litar që na lidhte me lopën çdo ditë,  
që na tërhiqte qosheve të parcelës  
bimët e gjelbra shpesh i ka goditur.

Dëmtuam parcelat, kopshtet personale,  
me shokët, komshit u zumë;  
ej, si nuk kishim parë më larg —  
ai litar pas lopës, ç'horizont i ngushtë!

**1982**

## ANTENA E TELEVIZORIT

Televizorin vuri dhe xha Jahua  
i nipi ngriti lart antenën  
pasi preu degët e një peme.

Xha Jahua që s'lejoi kurrë  
të pritej qoftë dhe një degë  
për televizorin s'iuh dhimbs as edhe pema.

E mes kopshtit u shtri  
dhe një pemë e hekurt  
me degë prej copëra telash.

Xha Jahua s'kursen pemët e kopshtit  
që antena krahët lirshëm të shtrijë  
e në dhomë të hyjë gjithë atdheu  
veprat e mëdha, qytetet e reja.

## **FËMIJËT E KOPSHTIT NË KOMPLEKSIN E LOPËVE**

Dhe këtu me të bardha qenkan tetat,  
të dashura, të mira, si edukatoret  
na marrin për krahu  
por frikë nuk kemi.

Lopët laramane, sa të mëdha,  
sa të mira, sa të urta!

Po qumështi nga gjiri këtu nuk buroka,  
qumështi nga tubi mbushka bidonat!  
Si çezmë qumështi i bardhë,  
qumësht plot.

Lopët të urta, grazhdi plot jonxhë,  
nga bari e jonxha qumësht i bardhë.

Grazhdet u mbushkan, pastrimi me makineri.  
Këtu s'qenka stallë  
qenka fabrikë.  
O, ne nga lopët tani s'kemi frikë.

Na puthin tetat, na lëpin lopa flokët,  
qeshen gjithë shokët të gëzuar,  
tetat me të bardha e sa të dashura  
ngrihen herët që menatë  
që ne të kemi që në mëngjes në gota  
qumështin e bardhë,  
u puthim duart tetave,  
i puthim në ballë.

## VJEN PRANVERA

Pranvera po vjen  
me dushin e shirave të butë,  
shpëlan kokat e maleve nga shkuma e dimrit,  
po ngjitet nëpër kodra  
duke tundur tufat e luleve,  
po ngjitet duke u çlodhur  
nëpër stolat e brezareve.

Pranverë e sivjetshme,  
më të mëdha tufat e blerimit mbi supe,  
tufat e luleve të pemëve;  
tufat e buzëqeshjeve.

## NGA RRUGICA NË UDHËT E GJATA

*Herorit të Popullit Myslym Shyri*

Rrugicat e qytetit u shtrinë në Pezë,  
Në Dumre, Vithkuq, në Tomoricë...  
Nga Jugu në Veri  
u zgjatën anekënd Shqipërisë.

U shtrinë krismat e rrugicave  
nga atentatat në betejat e mëdha...  
Ti i pari i fjalës, i pari i pushkës,  
ti komisar dhe luftëtar.

## **ÇELËSI I MALLIT**

Me shokët e përçolli nëna për në luftë  
të vetmin bir,  
në përfytyrimin e saj gjithnjë mbeti  
ai me fjalët — «Nënë, do të vij!»

Ndaj çelësi i derës si gjithnjë  
rrri te një e çarë muri  
si në ato ditë ilegale,  
si në ato ditë lufte.

U kthyen shokët, u kthyen,  
më pak ishin, por më shumë duke shin  
se vinin me lirinë.  
Nëna plot e ndieu shtëpinë.

Ishte me një, u bë me shumë bij.  
Dhe priste nëna përsëri,  
pas derës që hapej dhe mbyllej nga  
njerëzit.

Por çelsi i derës — çelës malli, pritjeje  
i zemrës së madhe të nënës prapë  
do të vihej tek ajo vrimë e vogël muri  
nën një rrasë guri.

**1982**

## VIGJILENCE

Kjo fjalë ka formën e shpatës  
ka formën e tytës së pushkës  
ka formën e grafikut të plotësimit të planit  
të grafikut në ngjitje lart,  
ka formën e syrit të hapur  
ditë apo natë.

1982

## NË PËRVJETORIN TËND

Në përvjetorin tënd, Parti,  
gjithë populli duarplot  
me ballin lart ndritur nga dielli i sukseseve.

Në përvjetorin tënd vijnë  
gjyshërit me ballin e fshirë nga rrudhat,  
gra-burra, të rinj, të reja-bulloqe të çelikta,  
fëmijët e njomë me buzët e qeshura  
porsi perspektiva.

Me ty, Parti, në krye rrokullisëm kohërat  
jo si rrotullim i tokës që jep stinët,  
me forcën tonë të luftës, të sakrificës  
e kthyem nga dritë e komunizmit.

Ti, Parti, me ne si në ditë të vështira dhe të  
mira,  
ndaj rrjedhin lumenjtë e gëzimit për ty,  
rrjedhin në detin e dashurisë për ty;  
lumenjtë ecin para, mbrapsh pa u kthyer.

Ngre klasa më e gëzuar se kurrë  
kovat me metalin tonë të shkrirë,  
llampat me plot energji,  
vargmalet me hekur, bakër e krom  
— gotat urim  
për Partinë.

Të gjitha urimet sot në një urim për ty,  
të gjitha zemrat — në këngën për ty.

Vjen kooperativisti  
me ujëvarën e bollëkut,  
jo veç në fusha, por në brezare të kodrave.  
Vjen me rreshtat e agrumeve të bregdetit,  
me bollëkun e arave, pemishteve, vreshtave.

Në përvjetorin tënd fëmijët — mëngjes i  
qeshur  
urim i shpërthyer me fishekzjarre,

me tullumbacet deri në qiel.  
Dorën tënde, Parti, ndiejmë si dorë nëne.  
Urimet më të zjarrta i ngre sot.  
Ecën gjithnjë përpara — punëtor dhe ushtar,  
ecën me hapin e mëngjesit.

Vijnë veteranët në këtë jubile  
me kapituj të tërë kujtime betejash,  
vijnë të rinuar si në pranverë  
kur sythet e rinj çel pema.

Festë e Partisë — festa e të gjithëve,  
festa e çdo zemre shqiptare,  
festë që kalon tejpërtej cakun e kufijve.  
Si sy i mprehtë i shqiponjës — vigjilanca,  
si gjoks i shkëmbit — qëndresa.

Lart, lart në çdo dallgë e stuhi,  
lart e më lart ngre sot flamurin e  
marksizëm-leninizmit  
ndaj më të mëdhatë urime rrjedhin për ty,  
më lart, deri në qiel  
fishekzjarret e gëzimit.

**1981**

## DY VIJA HEKURI

Dy vija hekuri-dëshmi  
të viteve tona aksioniste,  
dy vija paralele, paralele  
me gjelbërimin e vendit në rritje.

Shtrimë shina hekuri  
dhe në fushë mbi ura e tunel,  
dhe më të vjetrit dhe më të rinjt'  
porsi këto shina — paralel.

Shina hekuri shtrijmë më të rinj  
deri në Shkodër, e nesër në Vlorë,  
shinat si gjymtyrë  
të hekurt të atdheut tonë.

Dy shina të hekurta, të gjata  
mes fushave, blerimeve,  
dy vija paralele të shtrira  
si dy fije çiftelie.

**1982**

## TOKA E RE

Ka hyrë mes shkurreve e ferrave  
sa gjatë-gjerë,  
ka hyrë fusha e shtrënguar me breza  
mbi shpinën e kodrës së tërë.

Ngjyrat e ndryshme ua merr stinëve  
të blertën, të verdhën, kafen;  
ajo si shamia e aksionistëve  
hedhur pas qafe.

Sfidon ferra, shkëmbinj, shterpësinë,  
ngjyrat pa jetë, të pavlefshme;  
ashtu si të rinjtë që i dhanë stolitë  
ë hoqën çdo ferrë në ndërgjegje.

Tokë e re në këtë shpinë mali të hirtë,  
fushën e re me malin përqafuar —  
tufa të blerta në duart e të rinjve  
aksionistë —  
bukë e re në tryezën e shtruar.

**1983**

## **TRASTA E MIELLIT**

Një trastë e bardhë plot me miell,  
një trastë e bardhë e arnuar  
e shkund gjyshja, por e mbush prap'  
diçka e zymtë nga kohë e shkuar.

Sa dhëmbje ngjalte e sa dëshpërime  
kur varej bosh ajo trastë,  
kur e shkundte gjyshja mbi lakra  
pluhurin e miellit porsi gjalpë.

Mban ajo ato dhembje të rënda,  
ato vite të shkuara varfërie,  
ajo trastë grumbullim i shqetësimeve  
tek ajo dhe syri i shqetësuar i fëmijëve.

Kur ish bosh ajo trastë nata ish e gjatë,  
gjumi largohej me net të tëra...

Kërcënim i urisë bëhej i egër,  
dhembjen më të madhe e ndiente nëna.

Dhe pse sot bukë kemi plot  
e bollëkun e miellit e ndien  
përsëri atë trastë të vjetër e mbush  
e do ta shoh të mbushur me miell.

O gjyshe, po shkunde përgjithnjë,  
shkunde, mos e mbush më,  
shkunde atë kujtim vitesh të shkuar  
bollëk Partia krijoi në çdo vend.

**1983**

## BIOGRAFI E SHKRUAR ME GJAK

Ai nuk arriti të lejë në dokumentat e tij  
biografinë e shkruar me penë e bojë,  
atë ditë dimri u plagos në brinjë,  
gjaku i skuqi përmbi dëborë.

Ai nuk e ndërpreu betejën,  
vazhdoi luftimin deri në fund...  
Si një mal mbështetur kokën te retë  
mbi dëborën e bardhë u ul.

Zëri i tij i fortë mbeti  
te krismat e pushkëve, mortajave;  
buzëqeshja e tij ashtu treti  
me vështrimin te liria, e ardhmja.

Ai nuk arriti ta shkruaj' biografinë  
me dorën e tij, bukur me bojë;  
me gjak e la të shkruar aq mirë  
në një fletë të bardhë prej bore.

## DIELLI NË ÇDO SHTËPI

**MOS U DËSHPËRONI SE UNË PO SHKOJ  
SE PRAPË DO TË KTHEHEM NË SHTËPI.**

Nga letra e një dëshmori

Ai do të kthehej patjetër  
sepse do të vinte liria.  
Kur liria vjen, pas saj martirët vijnë,  
kthehen të gjithë te shtëpia.

Ajo është dielli, ata — rreze të tij,  
mal më mal ndrijnë...  
Rrezet e diellit shtrihen kudo,  
në çdo shtëpi hyjnë.

## MË SHUMË BARDHËSI NË ZEMËR

Këto ditë lodhja ikën,  
dita i gjen në arë,  
parcela e pambukut  
si liqen i bardhë.

Përparëset e mbushura  
plot bardhësi,  
me basma për vajzat,  
për nuset plot stoli.

Derdhet gëzimi i tyre,  
brenda në parcelë  
si një rrjedhë e bukur  
që derdhet në liqen.

Bardhësinë gjith' ditën  
në përparëse e mbajnë,  
por më shumë bardhësi  
në zemër kanë.

## KUMBULLA ME NJË KRAH TË GJATË

O qenka përsëri atje te oborri i shtëpisë  
kumbulla me një degë të gjatë  
si krah që na përfshinte neve fëmijët  
të tundeshim në një shilars me litar.

E mbi ate krah pas vitesh  
tundet në kujtesë fëmijëria jonë  
— si flutur e hedhur nga degë  
qielli te këmbët, oborri mbi kokë.

O qenka po ajo kumbull e gjatë  
me atë degë të shtrirë anash si krah,  
po ai krah s'i mbledh më moshatarët,  
ai krah sot mbledh shtëllungën me mall.

Moshatarët tanı tundin malet,  
përdredhin kokat e lumenjve në tunele,  
por ndonjëherë dhe imtësitë e vogla  
dredhin papritur zemrat e poetëve.

## TË PRESIN NË FSHAT

Ti erdhe për herë të parë në fshat;  
në rrugë hase rastësisht me një pengesë,  
ishte ai që punën e la,  
u nis në qytet me një shportë vezë.

— Ç'të duhet fshati, s'është punë për ty,  
kaloje stazhin një ditë po një jo,  
është punë e rëndë në bujqësi  
baltë e pluhur ke në çdo kohë.

Ai desh të të futë në një botë të vogël  
por bota jote është shumë e madhe,  
ai humbi në të si në det një gogël,  
ai u fshi nga dallga e fjalëve.

Ti erdhe, o shoqe, në fshat vullnetare,  
këtu sigurisht puna s'është lehtë,  
këtu si uzina nuk është e mbuluar  
në ara do të të rrahë shiu e dielli i nxeh të.

Ti erdhe, o shoqe; të presin me krahë hapur  
shoqet duke qëndisur qilimin e parcelës,  
të presin arat me krahët e brazdave,  
të presin pemët me lulet e pranverës.

## MAKINA LARËSE NË FSHAT

Ajo kuti e çuditshme  
tërhoqi kureshtjen e fshatarëve.  
— Sa mirë, sa mirë, i lumtë —  
ndihej zëri i grave!

Ajo kuti — objekt diskutimi  
pëshpëritje në shesh e në krua:  
«Ej, ç'paska blerë, budallai,  
iu dhimbaskan duart e gruas!»

E solli i pari në shtëpi  
le të ndrisnin këmishët, çarçafët,  
të përtërihet kohë e lirë e grave  
e vonë s'i bëhet për fjalët e disave.

Mendimet e llafazanëve  
si çarçafët e papastër  
të nevojshme e kanë  
në makinë larëse.

## DHËNDRI

Ai nuk kishte lënë punën një javë si njëherë,  
atë ditë rinia kishte aksionin e barit në bjeshkë.  
Habia e fanatikëve — litar i pyetjeve të gjata:  
— Ku është dhëndri? Pse kështu bëhet dasma?  
Ai u kthye nga aksioni pasdite  
kur qenë mprehur shumë llafet e fanatikëve.  
Ai ecte me sfurkun e barit në krah hedhur  
në majë të tij i shpuar tej ky zakon i vjetër.  
Ai u nis për t'marr nusen në fshatin për karshi.  
Ai me nuse krah për prah si dy yj.  
Romuzet shpërthyen, pëshpërit një llafazan:  
— Qyqja, nusja në fshat pa vello, pa duvak!  
Kur një zakon i vjetër bie, njihet një i ri,  
fshati — një anije mbi dallgë stuhish.

## **BUROOKRATI ME ÇIZMET PLOT BALTE**

Ish nëpunës, me dëshirë erdhi në prodhim  
dhe vështirësi në cilësinë e punës do të ketë në  
fillim.

Brigadier, ti s'ke të drejtë të flasësh prapa krahëve:  
«Ku di të punojë ai, vjen nga radhë e burokratëve.»

Po si nuk e more shatin të punosh me të në rresht,  
vetëm njëherë të prashitësh misër apo vresht?

I thua atij burokrat pse njeh dhe punën me laps,  
po burokrat je ti dhe pse ke çizmet plot baltë.

## **SHTËPIA E RE**

Shtëpia e re e Dalipit zbriste nga mali  
me gurët e rëndë për themele,  
çatia e saj zbriste nga pylli  
në krahë të shokëve.

Shtëpia e re ngrihej në fshat  
si shkëlqim i gjëzimit të të gjithëve.  
Shtëpia e re — unitet i kolektivit  
përjetësuar në gur.

## ËNDRRA E SAJ...

Ajo është më aktivistja në hekurudhë,  
brigadiere e brigatës së dalluar,  
balli si bjeshkë lart dhe krenar,  
sytë si uji kulluar.

Ëndrrën e saj, si flutur  
shkesi brenda mureve dot s'e mbylli,  
s'e mbuluan me duvak fanatizmi  
ëndrra e saj — një gonxhe prilli.

Ëndrra e saj e bardhë  
çan hapësirës së trasesë,  
ëndrra e saj e përbashkët  
me shokun që njoihu për jetën.

Endrrën e saj nuk e bren dot  
se dhëmbët i thyen thashethemexhiut,  
ëndrra e saj — stinë e hekurt,  
ëndrra e saj — një gonxhe prilli.

## FJALËT UJË

Fjalët e tua plot ujë  
në diskutimet, kritikat për të tjerët,  
ujë plot në muhabete,  
fshati i gjithë përmbytet  
në detin e fjalëve të tua thashetheme.

Po mjaft.  
Uji po të kalon te këmbët,  
uji për vaditjen e misrave,  
hapi vijë të gjerë në mes,  
uji po derdhet kot, kot lumë  
si fjalët e tua.

Mjaft,  
veri frerin gojës,

veri shatin ujit  
të rrjedhë nëpër ara,  
nuk i duhen kujt  
fjalët e tua - ujë.

## **QYTET DHE FSHAT**

Pranë këtij fshati, rrëzë malit, uzina vendit i dha më shumë gjallëri.  
Ngjitur me fshatin për punëtorët lartohen kaq pallate të rinj.

Ato pallate janë pjesë e qytetit ndaj qyteti i merr,  
pavarësisht se qytetarët për adresë emrin e fshatit venë.

Ato pallate janë qytet i vogël,  
krah i zgjatur i qytetit të madh,  
si krah që i bie mbi shpatull fshatit porsi vëlla.

Nga fshati shkojnë djem punëtorë  
derdhin metal në uzinë,  
nga qyteti në fshat shkojnë të reja,  
brazdat si fije në tezgjah shtrijnë.

Qytet dhe fshat dyqanet bashkë,  
kinemanë e shtëpinë e kulturës.  
Njëlloj antenat e televizorëve ngritur  
si në tarracën e pallatit e në majën e kullës.

Qytet dhe fshat këtu bashkë  
vetëm emrat të ndryshëm kanë,  
këtu nuk është një rast i veçantë  
ku kaq të shkurtër distancën e kanë.

## B R E Z A R E T

Kodrat në fillim i ndien  
si fasho të buta mbi plagët e shkurreve dhe  
ferrave.

Kodrat pastaj afër i ndien  
si buzët e ngrohta të fushave të blerta.

E kishim parë ylberin aq bukur  
nga kodra në kodër i harkuar,  
brezaret — ylbere të prekshme  
nga dora e njeriut të krijuar.

## Z B R A Z Ņ T I

Ky është korridori i shkollës, kaq i gjatë!  
Nxënësit në pushime janë.  
Iku ajo zhurmë, gumëzhitja e madhe,  
shyqyr- tha njëri, na ranë veshët rehat.

Korridori i gjatë. Zbukurime po vemë  
gati ta bëjmë për vitin tjetër.  
Kjo heshtje e bën atë dhe më të gjatë.  
E sa zbrazëti në zemër!

Në qoshe të tij një çerdhe është ngritur,  
si askurrë sot tërheq vëmendjen e të gjithëve;  
vallë a do të kishte ajo kënaqësi  
pa ato cicërimat e dallëndyshes?!

## **QYTETI BUZË LIQENIT**

Ai ngrihet krejtësisht i ri;  
sipër Gjalica krenare — deri në quell,  
poshtë përsëri Gjalica shtrirë deri në thellësi.  
Qytet i ri, i larë me freskun e bjeshkës,  
i spërkatur me stërkala uji,  
i spërkatur me dritë;  
qyteti më i ri,  
lapidar i qytetit të vjetër  
të fliuar për dritën.

Me lëndë pishën e maleve të këtij rrathi,  
me duart e djersën e gjithë qyteteve të tjera  
ngrihet ai si monument solidariteti.

## MES NESH GJITHMONË

*Atë ditë, kur kooperativistët e Shishtavecit  
në Kukës kërkuant që kooperativës së tyre  
t'i vihej emri «Hysni Kapo».*

E rëndë qe ndehur dje varfëria,  
kasollec acar e një trung nën kokë  
arat e varfra, kodrave, brinjave  
thikën e shtypjes deri në kockë.

\*  
\*      \*

Në Tiranë Enveri themeloi Partinë  
dhe këtu bijt' - yje dolën partizanë,  
sofrat bujari ndillnin për Lirinë,  
arat buzëqeshnin për fukaranë.

Partia në derë të çdo shtëpie  
zgjonte më të shtrenjtët bij të saj,  
komisar Besniku, udhëheqës Partie,  
vjen në ballë të Korparmatës Parë.

Mes partizanësh, i thjeshtë ndër të thjeshtit,  
gojëmjalti — shoku komisar!  
Me armiqt' aq i prerë, i rreptë,  
në betejë udhëheqës sa dhe luftëtar.

Me të pranë e ndiemë Drashovicën, Gjormin,  
kockën e Tërbaçit njohëm mirë,  
unitetin Jugë-Veri forconim,  
Partia e kaliste të fortë si çelik.

E pritëm atë si bir të vetëm,  
ia thamë rrobat, i qepëm çorapet;  
ulur tok hëngrëm bukë thekre  
nga një vakt vetëm dhallë e patate.

Në ballë me ne kur u ramë gjermanëve,  
bajraktarëve rrënjet kur ua grnim,  
kur mes vështirësive që na ranë  
pushtetin e të varfërve po ngrnim.

\* \* \*

Dielli i lirisë çdo kasolle ndriste.  
Ish pranvera në hyrje, mars.  
Shkollat hapan. Fëmijët harliseshin  
edhe pse bukë kishim ende pak.

Partia maleve u rriste horizontet,  
u vinte në ndihmë. Të mos vuaj askush.  
Por të vetmuarve përparimi u vononte,  
gishtérinjt' janë të dobët po s'u bënë grusht.

Dhe te ne ajo ishte luftë e madhe,  
luftë për socializëm, për zhvillimin:  
të ndërtohen shkolla, rrugë, spitale,  
të harlisej toka nga prodhimi.

Duhej dhe kooperativë të ngrinim...  
Armiku i klasës mina fjalësh vinte,  
deri në rrëzë atë gjuhë e grnim,  
gju më gju me njerëzit duhej puna bindëse.

Pranë nesh gjithmonë Partia gjëndej,  
shoku Hysni Kapo vinte mes nesh

dhe rritej besimi se do ta bëjmë të fuqishme kooperativën këtu në Shishtavec.

Në shtëpitë e reja, në bisedat e ngrohta  
biri ynë, Hysni, gjithmonë komisar;  
lëvizte në venat e zemrave tona  
gjaku i pastër revolucionar.

\*  
\* \* \*

S'e besonim se kaq para do të venim  
nga një ka i vjetër, një arë te brinja  
nga dy dhi, një plor që me zor e gjenim  
te traktori, makina e turbina.

Nga druri i pishës te dritat që erdhën,  
te radioja e televizori që buçet,  
nga xhamia e mykur te shkolla e çerdhet,  
te klubi e hoteli piktoresk.

\*  
\* \* \*

Nga ne ai s'ndahet asnjëherë,  
bijt' si Besniku mbeten në histori.

Do të jetë për ne më i madhi ndër  
që kooperativa të mbajë emrin e tij.

Mes nesh atë ta kemi gjithmonë;  
Tërbaçi, Shishtaveci për të ishin një,  
vendlindja e tij çdo skaj i atdhcut tonë  
në Jug dhe në Veri.

## **DUKE DËGJUAR KËNGËT E VJETRA POPULLORE TË LUMËS**

- 1. O fushë e Korabit,  
e mjera unë!...**

Nga kjo fushë e vogël  
burrat i përcillnin,  
pas majës si thikë  
një nga një humbisnin.

Të shtangura gratë  
nga maja vërenin,  
burrat humbisnin  
kokat pas s'i kthenin.

Mbyllej horizonti,  
prapa tij — natë,  
prapa tij — kurbeti,  
greminë për gratë.

E zëri i grave  
veç kthehej në vaj,  
gjoks' i tyre - shpellë  
e dhimbjes paskëtaj.

E mjera unë!...

2. E more pampor, pampor me kimet  
këtij ushtarit të ri mos i jep zamet.

\* \* \*

Iknin djemt' me vite të tëra,  
malli për ta si gurrë ndizej brenda.

Nusja e re do të thinjej si dëbora,  
vajzës për martesë do t'i kalonte koha.

Ara pa djem tē rīnj pēr tē mbjellē,  
pyll pa djem tē rīnj pēr t'u prerē.

Ara tē mbjella pērgjysmē pa u korrur  
dhe delet nē bjeshkē mbetēn pa u kullotur.

Nēnat me mallin netve u mbështollēn,  
zjarri i mallit than diellin, shkrin borēn.

### **3. Krisi pushka bregut Drinit jam e motra e Selman Brahimit**

Erdhi koha pēr tē kositē,  
kosa jote nē bjeshkē ështē ngjité.

Pēr prashitje koha erdhi,  
shati yt pa njeri s'mbeti.

Erdhi koha t'i hipim kalit,  
kali yt prini i pari.

Dhe kudo çelin pemë të reja,  
e kudo lulëzon pranvera.

E kudo ti je me ne,  
re në luftë e vdekje s'ke.

**4. Shkon djali sokakit këpucët tue vizëllue,  
ia hodha një ftue, hiç nuk u kujtue**

Ta hodhi ftoin nga gjiri i saj,  
e kishte mbajtur ngrohtë porsi zjarr.

Ç'pate, u hutove, o djal i ri,  
ish vajza e fshatit që të don ty.

E hodhi atë ftua si zemrën e saj,  
e hodhi atë ftua s'kish nevojë pér fjalë.

E hodhi pa frikën e ligjit të kanunit,  
e hodhi, u drodh rrugë e katundit.

E hodhi ajo, e para të qëlloi,  
zemrën për jetë, djalo, të plagosi.

S'trembet dashuria e t'rinxve të katundit  
nga krismat e pushkës së kanunit.

**5. Lumë e lumë, mori dardhë,  
për uj' t'ri jemi to ardhë**

Kënga më çon deri në fëmijëri,  
ngriheshim me natë për ujë të ri,  
ngriheshim mbillnim shelgje të reja  
që ujë të kishin, të mbeteshin të blerta.  
Shkonim kështu sipas zakonit,  
por rrjedhën e as ujin s'e kishte në dorë zoti.  
Ujë i bollshëm, blerim i përhershëm,  
nuk e sollën lutjet ditën e verës.  
E sollëm me aksion që mori rinia,  
kur tunelin e çau me krisma e mina.  
Dhe sot në verë lule mbledhin fëmijët  
e gëzueshëm i hedhin në kanalin ujitës.

## DERA HAPUR RRI

Vjen vera e vjeshta,  
dimri me dëborë,  
pranverë me lule  
— lule e tharë ajo.

Vijnë shumë në shtëpi,  
dera hapur rri,  
zemra derën hapur  
dhembja nuk e mbyll.

Në ëndërr na vjen,  
librat gati në çantë,  
përparësen e zezë,  
qaforen e bardhë.

Detyrat e bëra,  
shoqet ja të presin.  
— Ua ç'fustan i ri —  
gajasen së qeshuri.

Por ah kjo ëndërr!  
Dhembja gjembaht shton.  
Zemër apo gur  
prindrit kanë në gjoks.

## AJO TRIKO

Ato vite pas Çlirimtit vetëm një triko kishim,  
unë e vëllai në rastë të veçanta festash e vishnim.  
«Qëndisi një lule në gjoks», nënës i thoshja,  
por vëllai s'di pse lule nuk donte.

E veshi atë ditë kur shkoi për mik,  
por rrugës kishte takuar një të dyshimtë.  
Mbi shpatulla ndiente ai peshën e agimit,  
me vrapi shkoi në postën e kufirit.

Në përlleshje me diversantët dhe ai ra,  
trikoja në gjoks çeli një lule me gjak.  
Të vrarë s'më lanë ta shihja, isha i vogël,  
veç trikon e re me lule ma sollën.

— Mbeti tashti jotja, — tha nëna, — përgjithnjë,  
ta lajmë pak e vishe se të rri mirë.

— Jo, nënë, mos e laj, lulja e gjakut mos të prishet,  
kjo triko në muze u takon të gjithëve.

**1982**

## DURRËSI

Qyteti me gjymtyrë betoni të pallateve shumëkatëshe,  
të fabrikave, të shinave,  
me gjymtyrët që zgjaten deri në det  
  me portin, vaporët  
me gjymtyrët e hekurta.  
Mbi kokë kapelen e blertë.

Qytet i lashtë,  
qytet i ri  
me rrënjet thellë në lashtësi,  
me degët lart në ditët plot drithë.

Qyteti në mbrëmje duket mbi shtylla drithash  
ngulur në det.

Qyteti ditën praruar në diell  
me sofrën e plazhit shtruar për kaq shumë mysafirë

Qyteti i punës,  
i çlodhjes, përtëritjes.

## NË QYTETIN E LIBOHOVËS

Shtëpitë e reja të ngopin sytë,  
dyqanet, pika çlodhëse buzë ujit  
që derdh freskinë e malit aq mirë.  
Si një çadër e blertë  
rrapi lëshon degët  
plot freski.

Aty mblidhen burrat,  
mblidhen vizitorët,  
një bisedë për Avniun  
e para do të fillonte.

## K S A M I L

1.

Dje.

Kodra me fytyrë nga uji,  
kodra tē etura  
me shkëmbinj, shkurre e ferra.

Kodra tē thata por tē dashura  
nē sy tē mërgimtarit  
ndër dhera tē huaja.

2.

Sot.

Shkallë tē blerta buzë Jonit

rroba blerimi veshur,  
qytet i ri si perlë mes agrumesh,  
qytet i rinisë së qeshur.

## NËPËR SKELAT E LARTËSIVE

**poemë**

Lartësi malesh prej gjaku e djerse,  
lartësi prej tullash, betoni e hekuri,  
lartësi prej pyjesh, oxhaqesh, vinçash,  
lartësi prej pallatesh të shumta,  
lartësi majash, digash gjigante.

— Lartësi e viteve të epokës së Partisë  
nga ku horizontin zgjeron fantazi e poetëve.

Nëpër skelat e lartësive  
përshëndes shokët,  
ata që montojnë ditët e reja të begata  
paralel me kreshtat e kodrave, maleve,

kreshta kullash, vinçash, oxhaqcsh.  
Në Bradasheshin e dikurshëm,

të përblytur nga moçalet, nga ujërat,  
shokët punëtorë të metalurgjisë  
peizazhin e ri me pemë të hekurta,  
me trungje oxhaqesh gjigante ngriten,  
romantikë e re me epikën e ditës.

Njatjeta, shokët e mi të metalurgjisë!  
Me ju na lidhet çdo punë jona,  
me veprën tuaj  
lidhen muskujt e hekurt të qyteteve tona.

Njatjetani, shoqe!  
Sa shumë qenkeni këtu?!  
Dora juaj mbajti shpatën e Mamicës,  
koburen e Shotës, pushkën e Zonjës,  
kazmën e Shkurtës,  
dora juaj mban levën e vinçit pesëtonësh  
ajo dorë e butë, po dorë hekuri vdekjeprurëse  
për çdo kanun e paragjykim të vjetër.  
Në ulluqet e zjarrrta digjen  
synimet e NATO-s dhe Traktatit të Varshavës,  
çahen bllokadat  
nga rrjedhë e çelikut të zjarrtë.

## 2.

Janë lartësitë e viteve tonë  
që e shtrijnë horizontin e fantazisë së poetëve,  
ylberin e fantazisë që lidhte dy malet  
e ktheu në beton e hékur  
që lidh dy brigje të Drinit.

Drin, o lumë i dashur,  
mbi ty lundronte vetëm varka prej letre  
e fëmijërisë sime,  
mbi ty sot lundrojnë anije të mëdha,

ti rrjedhë vuajtjesh e fatkeqësish.  
Sot me buzët e digës nise të buzëqeshësh,  
nise krahët e telave më dritë energji  
hyre në dyert e shtëpive, në uzina, fabrika.  
Janë duart e punëtorëve që të përdredhin  
kokën  
të kalosh në shtrat të ri prej tüneli betoni,  
janë duart e minatorëve në bregun tënd  
që malin e shpuan,  
me çelësin elektrik e bëjnë të tundet  
një shatërvan prej gurësh në luginë,  
një shatërvan resh mbi Drin.  
Spërkat valë e Drinit mbi ballin e minatorit,  
balli i tij përshkuar nga vija të gjata,

Muzikant, këto pikla djerse, këto vija në ballë  
a s'janë si nota mbi pentagram?

Në zemrën tuaʃ, minatorë,

gëzim — shpërthimi i këtij masivi, më i gëzuar nesër dita e përrurimit.

3.

Nga lartësi e këtyre viteve të vështrosh  
madhështore pamja e atdheut tim,  
mbi rrugët e dhive, mbi shkrepë e gurë  
rrugët e reja si gjerdane të bardha,  
ato rrugë të gdhendura me litar në shkëmb,  
ato rrugë të çelura me dinamitin e zemrave të  
rinisë,  
ato vite të para të nisjes së aksionit.

«Me hapa vigane ec, moj rini,  
sulm për të çelur rrugën Kukës-Peshkopi».«  
Rrugë të shumta si damarë  
nëpër trup të Shqipërisë.  
Rrugë të reja hekuri nga Shkodra deri në Han  
të Hotit,  
nga Fieri në Vlorë,

me rrugë hekuri lidhur deti me liqenet,  
lidhur Veriu me Jugun,  
fusha me malin.

Rrugë hekuri — rrugë të rinisë,  
ju sillni Veriun në Jug,  
Lindjen në Perëndim e anasjelltas,  
sillni dërrasat e Fushë-Arrëzit në Jug,  
kripën e detit në Veri,  
míneralin e Rubikut, të Përrenjasit, Gurëkuqit  
në furrnaltat me gojë hapur,  
sillni gjymtyrët e fabrikave, turbinave të reja,  
ju arteriet e qarkullimit të madh të Shqipërisë.  
Rrugë hekuri,  
ju shkurtoni distancat mes fshatrave e qyteteve,  
afroni më shpejt takimin me njerëzit,  
  me të afërmit,  
ju një shtrëngim i hekurt i duarve në  
  vallen e unitetit,

ju, rrugë hekuri — rrugë të rinisë  
afroni plazhin me qytetin,  
afroni pushimin, çlodhjen, mirëqenien  
  e njerëzve,  
ju shina të hekurta  
— gjatësi e shtrirë në lugina, fushave të gjera,  
gjatësi, por në stendat me grafikë  
  të sukseseve  
shënoni lartësi.

4.

Lartësitë në rritje çdo vit,  
lartësitë më kodra brezaresh,  
lartësi me kodra drithi nëpër lëmenj,  
lartësi fshattrash të rinj.

Lartësi e fshatit

më poshtë, më e vogël bën të duken e vjetra,  
zakonet prapanike, kanuni,  
më pranë fushat e gjera pa fund  
të pastruar nga plagët e qelbura të kënetave,  
fushat e mëdhë, të shëndetshme  
ku blerimi qesh jo vetëm në pranverë  
por dhe në dimra të acartë  
dhe nëpër vera të thata.

Në kuotën e lartësisë fusha e mali  
me kallintë e mbushur plot  
krahas rrjedhës së zjarrtë të çelikut,  
rrjedhës së metaltë  
rrjedha e drithit zurret nga makina shirëse  
si një ujëvarë.

5.

Në lartësinë e kullës së naftës ka hipur fantazia,  
kapton gjithë puset,  
lejlekët me sqepin e hekurt që çukasin papushim  
nëntokën,

kapton gjithë konturet e kodrave të Ballshit  
bashkë me konturet e korpusit gjigant,  
në shtëllungat e reve zgjat ballin e djersitur  
oxhaku i lartë i kaldajës.

Nëntoka e vendit  
nëpër tubacionet si kapilarë  
drejt kësaj zemre të madhe të industrisë.

## 6.

Nëpër skelat e lartësive kudo shokët e mi  
ngrenë pallate, qytete të reja,  
lartësi të reja — vinçat e mëdhenj  
që brejnë me dhëmbë shtëpitë përdhese,  
shtëpitë me qerpiç  
e hapin themele

për pallate të reja.

Lartësi preç vinçash gjigantë  
që një faqe muri të tërë  
e venë përnjëherë në pallat  
si një kuti një mbi një blloqet e reja  
parafabrikat.

Tungjatjeta shoku vinçier,  
fëmijët bëjnë çudi kur ti thua  
hyrjen tënde në pallat  
nga kjo lartësi hekuri  
e ngrita lart me një gisht.

Tungjatjeta, vëllezër,  
ngjitur në skelat e lartësive!  
Ju montoni vitet plot vepra, plot suksese,  
mbani në gjoks medaljen sa dielli,  
ju mbani urimin më të madh  
me ju lart,  
lart, o klasë punëtore,  
ngjitim vitet.  
Ngjitim lartësitë e viteve të epokës sonë,  
botën e vjetër duke shtypur,  
duke groposur,  
duke shkulur urithin mikroborgjez  
në trupin tonë të shëndoshë,  
duke shkelur me këpucë të hekurta  
koka gjarpërinjsh  
që nën gurin lajkatar na nxjerrin kokën për  
kafshim.

Godasim bllokada, superfuqitë  
nga kjo kështjellë e lartuar nga viti në vit,  
kuota më të larta do të ngremë nesër,  
kuota lartësish me beton e hekur,  
me tulla e gur, me oxhaqe gjigantë,  
me oxhaqe e brezare  
lartësi të reja ngjit Shqipëria  
në epokën socialiste.

1977-1983

## P E R M B A J T J A

	Faqe
Nga Fierza në Kukësin e Ri .....	3
Bjeshkë, o bjeshkë .....	5
Malli nuk pyet .....	6
Rrjedha e grurit .....	7
Nga biseda me një pensionist .....	8
Ujëmbajtësi .....	10
Fshati im .....	11
Tufézimi .....	12
Antena e televizorit .....	14
Fémijét e kopshtit në kompleksin e lopëve .....	15
Vjen pranvera .....	17
Nga rrugica në udhët e gjata .....	18
Celësi i mallit .....	19
Vigjilencë .....	21
Në përvjetorin tënd .....	22
Dy vija hekuri .....	25
Toka e re .....	27
Trasta e miellit .....	29
Biografi e shkruar me gjak .....	31
Dielli në çdo shtëpi .....	33
Më shumë bardhësi në zemër .....	34
Kumbulla me një krah të gjatë .....	36
Të presin në fshat .....	38
Makinë larëse në fshat .....	40
Dhëndri .....	42
Burokrati me qizmet plot baltë .....	43
Shtëpia e re .....	44
Ëndrra e saj .....	45
Fjalët ujë .....	47
Qytet dhe fshat .....	49

Brezaret .....	51
Zbrazëti .....	52
Qyteti buzë ligjenit .....	53
Mes nesh gjithmonë .....	54
Duke dëgjuar këngët e vjetra popullore të Lumës .....	59
Dera hapur rri .....	64
Ajo triko .....	66
Durrësi .....	68
Në qytetin e Libohovës .....	70
Ksamil .....	71
Nëpër skelat e lartësive (poemë) .....	73

Nelaj, I.

Tufa gëzimi. Poezi. [Red.: I. Kadare],

T., «Naim Frashëri», 1984.

84 f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891. 983-1

N. 41